



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - Ministarstvo Inostranih Poslova i Diaspora
Ministry of Foreign Affairs and Diaspora

Datë: 15.03.2023

UDHËZUES PËR APLIKIM - PYETJET MË TË SHPESHTA

1. Çka janë subvencionet?

Subvencionet janë mbështetje financiare e projekteve të OJQ-ve dhe organizatave të tjera të organizuara në Republikën e Kosovës dhe në diasporë që kanë projekte në fushën specifike, të shpalluara në thirrje publike.

2. Kush mund të aplikojë?

Aplikues nënkupton OJQ-në e vendit ose të huaj, e regjistruar në Republikën e Kosovës në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare ose në regjistrin e organizatave joqeveritare në shtetet e huaja, ku është e koncentruar diaspora kosovare, e cila ka aplikuar për mbështetje financiare në kuadër të ndonjë thirrjeje publike për mbështetje financiare për OJQ-të.

3. Kush është përfitues?

Përfitues nënkupton OJQ-në vendore ose të huaj, e regjistruar në Republikën e Kosovës në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare ose në regjistrin e organizatave joqeveritare në shtetet e huaja, ku është e koncentruar diaspora kosovare ose organizatat e tjera dhe partnerët që janë kontraktuar sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

4. Mbi cilat rregullore dhe dokumente të tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës bazohet mbështetja financiare?

4.1. Rregullore MF – Nr. – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve;

4.2. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 – 2025;

4.3. Plani vjetor i mbështetjes financiare për OJQ-të - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

5. Sa ditë është e hapur thirrja publike?

15 ditë pune – 15.03.2022 – 04.04.2022.

6. Financimi do të ndahet në dy (2) kategori:

Kategoria I – Kampe apo shkolla Verore dhe Dimërore. Buxhet total € 175,000

Shuma minimale e mbështetjes financiare për projekt është € 15,000.

Shuma maksimale e mbështetjes financiare për projekt është € 25,000.

Kategoria II – Ekskurzione apo Programe natyrore apo kulturore. Buxhet total € 50,000.

Shuma minimale e mbështetjes financiare për projekt është € 5,000.

Shuma maksimale e mbështetjes financiare për projekt është € 10,000.

7. Me sa projekte mund të aplikosh?

Vetëm me një projekt.

8. Kur fillon zbatimi i projekteve?

Nga data 15 prill 2023 deri më 31 dhjetor 2023.

9. Objektivat dhe temat ku mund të aplikojnë OJQ-të?

DIASPORË DHE MËRGATA

Qëllimi i thirrjes financiare është ruajtja dhe kultivimi i identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të pjesëtarëve të diasporës dhe mërgatës, dhe lidhshmërinë e tyre me vendin përmes pjesëmarrjes në kampe verore/dimërore, shkolla verore/dimërore, si dhe shëtitjeve në natyrë dhe përmes punëtorive dhe festivaleve kulturore

10. Cilat janë format që mund të aplikojnë/dorëzojnë dokumentet?

Përmes postës elektronike (e-mail)
e-mail: projektet.mpjd@rks-gov.net

Mbishkrimi - Projektpropozim për subvencione

11. Kush e bën vlerësimin e përfituesve?

Komisioni për vlerësimin e projektpropozimeve, i përbërë nga pesë anëtarë.

12. Sipas cilave kritere bëhet vlerësimi?

Kriteret specifike të vlerësimit	Pikët
Kapaciteti i organizatës - a posedon organizata aplikuese aftësitë, përvojën dhe kapacitetet e strukturën menaxhuese për të zbatuar projektin.	
Aftësitë dhe përvoja menaxhuese në zbatimin e projekteve të ngjajshme?	10 pikë
Staf të mjaftueshëm për të zbatuar projektin?	10 pikë
Shuma financiare e menaxhuar në të kaluarën?	10 pikë
Totali i pikëve të mundshme	30 pikë
Relevanca e projektit/programit - sa relevant është projekt propozimi me fushat prioritare të thirrjes dhe sa janë të arritshme, qëndrueshme dhe zbatueshme aktivitetet e propozuara.	
Relevanca e projektit me objektivat dhe prioritetet e thirrjes?	10 pikë
Objektiva të qarta dhe të realizueshme?	5 pikë
Definim i mirë i ndikimit të projektit në përfituesit final?	5 pikë
Projekti fokusohet në rini dhe diasporë?	10 pikë
Totali i pikëve të mundshme	30 pikë
Buxheti - a janë kostot reale, ekonomike, dhe në përputhje me aktivitetet e planifikuara?	
A janë kostimet e aktiviteteve të detajuara mirë dhe reale?	10 pikë
A janë harxhimet relevante me nevojat e projektit?	5 pikë

A ka zotim për bashkëfinancim nga organizatat zbatuese?	5 pikë
Totali i pikëve të mundshme	20 pikë
Prioritetet	
A është propozimi në partneritet me organizata/institucione tjera?	5 pikë
A synohen si përfitues grupet relevante dhe a është definuar numri i përfituesëve?	5 pikë
A janë definuar mirë numri i përfituesëve të projektit?	5 pikë
A do të ndikojë projekti në rritjen e mirëqenies së grupeve të synuara?	5 pikë
Totali i pikëve të mundshme	20 pikë
Total pikë	100 pikë

13. Cilat dokumente kërkohen për aplikim?

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së (obligative);
2. Certifikata e numrit fiskal (obligative);
3. Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore *(nëse është e aplikueshme)* ;
4. Të ketë dorëzuar projekt propozimin të plotësuar në formatin e aplikacionit sipas kërkesave të thirrjes publike (obligative);
5. Të ketë dorëzuar propozimin e buxhetit në formatin sipas kërkesave të thirrjes dhe të plotësuar në tërësi (obligative);
6. Deklaratë e nënshkruar se për të njëjtin projekt nuk është pranuar financim i dyfishtë nga burimet tjera (obligative);
7. Pasqyrat financiare vjetore, dhe deklaratë se OJQ ka përgatitur dhe dorëzuar pasqyrat financiare vjetore, për vitet përkatëse sipas Kategorisë;
8. Një deklaratë me të cilën tregojnë se i kanë përmbushur detyrimet nga mbështetjet financiare publike të mëhershme;
9. Të dorëzoj deklaratat e partneritetit në rastet kur propozohet implementimi i projekteve në partneritet;
10. Të dorëzoj deklaratë mbi projektet e financuara nga burimet publike të financimit në vitin 2022 (nëse ka);
11. Të dorëzoj CV-të e përfaqësuesëve të organizatës që do të menaxhojnë dhe zbatojnë projektin;

12. Të dërgojë certifikatën statusit të përfituesit publik, nëse është e aplikueshme për organizatë;
13. Vërtetimi/konfirmimi nga banka përkatëse i llogarisë bankare të OJQ-së, si dhe qarkullimi për vitet përkatëse sipas Kategorisë (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
14. Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së.

14. Nëse kam pyetje, kujt mund t'i drejtohem?

Për të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike, pyetjet mund t'i bëni në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: sabrie.grainca@rks-gov.net

15. A kam të drejtë ankese, nëse nuk kualifikohem për mbështetje financiare?

Po, pas përfundimit të vlerësimit, çdo aplikant ka të drejtë të paraqesë ankesë. Komisioni i ankesave do ta shqyrtojë secilën ankesë.

16. Nëse shpallem fitues, cilët janë hapat e mëtejshëm?

Pas të jenë shpallur përfituesit, do të njoftoheni me shkrim dhe do të ftoheni për ta nënshkruar kontratën.

17. Si duhet të plotësohen formularët e aplikimit?

Formularët duhet të plotësohen me kompjuter, të printohen dhe të nënshkruhen nga bartësi i projektit ose përfaqësuesi i OJQ-së.

18. Sa projekte planifikohet të mbështeten përmes kësaj thirrjeje publike?

Këtë vit do të mbështeten 10-15 projekte.

19. Cilat janë shpenzimet e pranueshme dhe të papranueshme gjatë hartimit të planit të buxhetit?

Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes publike janë:

Përmes fondeve publike të kësaj thirrjeje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit/programit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

19.1. Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkte përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e disa aktiviteteve projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

- Organizimi i aktiviteteve edukuese, tryeza të rrumbullakëta (në mënyrë të veçantë duhet të identifikohet lloji dhe çmimi i secilit shërbim);
- Materialet shpenzuese;
- Shërbime grafike (prepress, shërbimet për shtypjen e fletushkave, broshurave, revistave, etj, duke specifikuar llojin dhe qëllimin e shërbimit, sasinë, çmimin e njësisë, etj.);
- Shpenzimet e pagave dhe pagesave për menaxherët e projektit/programit, të kontraktorëve të projektit nga organizatat dhe/ose partnerët e jashtëm të përfshirë në projekt (kontratat e të drejtave të autorit dhe të drejtave pronësore, kontratat tjera, kontratat e punësimit), duke specifikuar emrin e personave të angazhuar, kompetencat e tyre profesionale, numrin e muajve të angazhimit dhe shumën mujore bruto të kompensimit;
- Shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit, etj) këto shpenzime duhet të jenë të përcaktuara (caktuara);
- Shpenzimet e udhëtimit;
- Shpenzimet për transportin dhe akomodimin (aty ku është e nevojshme duke e specifikuar numrin e njerëzve, destinacionit, shpeshtësinë dhe qëllimin e udhëtimit dhe llojin e transportit publik, llojin e akomodimit dhe numrin e netëve);
- Kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e aktiviteteve të projektit apo programit;

19.2. Shpenzimet e tërthorta të pranueshme

Përveç shpenzime të pranueshme direkte, në kuadër të kësaj thirrjeje do të pranohen edhe kostot indirekte (përqindje e vlerës totale të projektit/programit. Në kuadër të këtyre shpenzimeve përfshihen kostot që nuk janë të lidhura direkt me zbatimin e projektit ose programit, por janë kosto që në mënyrë të tërthortë kontribuojnë në arritjen e objektivave të projektit. Edhe këto kosto duhet të specifikohen dhe të shpjegohen.

19.3. Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë p.sh:

- Investimet në kapital apo kredi për investime, fonde të garancisë;

- Kostot e blerjes së pajisjeve, mobiljeve, dhe punëve të vogla ndërtimore në qoftë se kalojnë vlerën prej 10% të totalit të kostove të pranueshme të projektit;
- Shpenzimet e interesit për borxhin;
- Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e procedurave gjyqësore;
- Pagesa e bonuse për punonjësit;
- Detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive, tarifatat për transfertat financiare dhe tarifatat e tjera krejtësisht të një natyre financiare;
- Kostot që tashmë janë të financuara nga burime publike apo shpenzime në periudhën e projektit të financuar nga burime të tjera;
- Blerja e pajisjeve të përdorura, makineri dhe mobilje etj;
- Kostot që nuk mbulohen nga marrëveshja (kontrata me ofruesin e mbështetjes financiare);
- Donacionet bamirëse;
- Kredi për organizata të tjera apo individ;
- Kostot e tjera që nuk janë të lidhura direkt me përmbajtjen dhe objektivat e projektit;
- Financim të çfarëdo aktiviteti të subjekteve politike.

Për të kaluar vlerësimin procedural, organizatat aplikuese duhet të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe specifike, të specifikuar më poshtë. Organizatat që e kalojnë fazën e vlerësimit procedural, vlerësohen në përmbajtje të projekt propozimeve.

20. Pasi ta kemi fituar mbështetjen financiare, si bëhet monitorimi dhe raportimi?

Sekretari i Përgjithshme e cakton zyrtarin ose ekipin për monitorimin e zbatimit të kontratës/projektit të përkrahur financiarisht. Raportimi bëhet në baza periodike, sipas përcaktimeve të Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve (kapitulli IV).

Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën projektet.mpjd@rks-gov.net, jo më vonë se **31.03.2023** në ora **16:00**. Pyetjet do të përgjigjen jo më vonë se **03.04.2023** në ora **16:00**.

Për qëllimin e kësaj thirrje për aplikim do të mbahet një sesion informues me datën **17.03.2023** nga ora **14:30** në MPJD.

Ju lutem, për më shumë informacione, lexojeni edhe manualin në kuadër të Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.